



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 235, datë 25.11.2021**

**PËR  
LICENCIMIT TË SUBJEKTIT “PORSCHE LEASING” SH.P.K. PËR USHTRIMIN E  
VEPRIMTARISË SË AGJENTIT NË SIGURIME NË KLASAT E JO-JETËS, NË EMËR  
DHE PËR LLOGARI TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “INSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Licencimin e subjektit “Porsche Leasing” sh.p.k., për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Insig” sh.a.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Ervin METE**